

Fall 9-2018

TURIZMI SI BURIM POTENCIAL PËR ZHVILLIM LOKAL EKONOMIK NË KOMUNËN E PRIZRENIT

Dua Karabaxhaku

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the Business Commons



Koleji UBT

Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

**TURIZMI SI BURIM POTENCIAL PËR
ZHVILLIM LOKAL EKONOMIK NË KOMUNËN E PRIZRENTIT**

Shkalla Bachelor

Dua Karabaxhaku

Shtator, 2018

Prishtinë



Koleji UBT

Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

Punim Diplome

Viti Akademik 2015/2016

Dua Karabaxhaku

**TURIZMI SI BURIM POTENCIAL PËR
ZHVILLIM LOKAL EKONOMIK NË KOMUNËN E PRIZRENTIT**

Mentori: PhD cand. Ermal Lubishtani

Shtator, 2018

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKTI

Ky dokument analize i cili është zhvilluar në kuadër të punimit të diplomës, në Fakultetin për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, të universitetit UBT, do ta elaborojë ndikimin e turizmit si kategori ekonomike dhe burim potencial për zhvillim lokal socio-ekonomik dhe kulturor të komunës së Prizrenit, duke e zbtuar në një metodologji tri dimensionale të analizimit të gjendjes së përgjithshme aktuale në sektorin e zhvillimit ekonomik, rëndësinë e turizmit si kategori e rëndësishme ekonomike, dhe si ndikon turizmi si burim potencial për zhvillim ekonomik dhe në sektorët e ndryshëm në Kosovë, me theks të veçant në komunën e Prizrenit.

Qëllimi i kësaj ndërmarrje është që të dëshmohet se sektori i turizmit mund të shndërrohet në një promotor të zhvillimit socio-ekonomik dhe kulturor në komunën e Prizrenit, duke e siguruar një zhvillim të qëndrueshëm, gjenerim të vendeve të reja të punës dhe mirëqenie më të lartë për të gjithë qytetarët e tij.

Të gjeturat nga këto proceset analitike dëshmojnë që komuna e Prizrenit ka parakushte, si dhe potencial njerëzorë dhe material për ta zhvilluar turizmin, në një sektor profitabil, i cili do ta fuqizojë zhvillimin ekonomik, hapë vende të reja pune dhe përmirësojë dukshëm standardin jetësor të qytetarëve të komunës së Prizrenit, dhe jo vetëm.

Fjalët kyqe:

Zhvillim ekonomik, burim potencial, standard i lartë jetësor, vende të reja pune, stabilitet makroekonomik të ekonomisë kombëtare.

ABSTRACT

This analysis paper developed in the framework of the diploma work at the Faculty of Management, Business and Economics of the UBT University, will elaborate the impact of tourism as an economic category and potential source for local socio-economic and cultural development of the municipality of Prizren, focusing on a three-dimensional methodology of analyzing the current state of affairs in the economic development sector, the importance of tourism as an important economic category, and how tourism is a potential source for economic development and in other sectors in Kosovo, with particular emphasis on the municipality of Prizren.

The aim of this undertaken is to prove that the tourism sector can be transformed into a promoter of socio-economic and cultural development in the municipality of Prizren, ensuring sustainable development, generating new jobs and higher welfare for all its citizens. Findings from these analytical processes prove that the municipality of Prizren has preconditions as well as human and material potential to develop tourism in a profitable sector that will strengthen economic development, open new jobs and significantly improve the living standards of citizens of Prizren Municipality, and not only.

Keywords:

Economic development, potential source, high standard of living, new jobs, macroeconomic stability of the national economy.

MIRËNJOHJE/FALENDERIME

Kam, kënaqësinë e veqant që ti shpreh falenderimet e mia më të thella për personat të cilit më kanë dhënë mbështetjen e tyre të parezervë gjatë tërë kohës që kam ndjekur studimet në Fakultetin për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, e këta janë prindërit dhe familja ime. Natyrisht falenderim i veqant i takon edhe mentorit tim, PhD cand. Ermal LUBISHTANI për mbikqyrje, koordinim dhe udhëheqje profesionale të punës, deri në finalizimin e plotë të këtijë punimi diplome.

Në mesin e tërë falenderimeve dhe Mirënjohjeve vend të rëndësishëm zënë institucionet e qeverisjes lokale, përfaqësuesit e OJQ`ve dhe të komunitetit të biznesit, për ndihmën, mirësinë, sinqeritetin, dhe mbështetjen konkrete në fazën e hulumtimit dhe të intervistimit, për informatat profesionale e ofruara të këtijë punimi.

Ky rrugëtim nuk do të ishte i mundur, pa mbështetjen dhe ofrimin e kushteve të duhura akademike të Fakultetit për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, pranë UBT`së.

PËRMBAJTJA

FJALORI I TERMAVE	VI
1 HYRJE.....	1
1.1 Efektet ekonomike të turizmit.....	1
2 SHQYRTIMI I LITERATURËS	4
3 DEKLARIMI I PROBLEMIT	9
3.1 Turizmi si kategori ekonomike për zhvillim të qëndrueshëm	9
4 METODOLOGJIA.....	12
5 PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE	14
5.1 Prezantimi i rezultateve.....	14
5.1.1 Turizmi si potencial për zhvillim lokal në Kosovë.....	14
5.2 Pasqyra e turizmit në Kosovë	15
5.3 Perspektiva e zhvillimit të turizmit në Kosovë	16
5.4 Roli i turizmit në zhvillimin ekonomik në qytetin e Prizrenit	18
5.5 Karakteristikat ekonomike të qytetit të Prizrenit	18
5.6 Ekonomia - Infrastruktura dhe Mjediti i Biznesit në komunën e Prizrenit	19
5.7 Analiza e rezultateve.....	22
6 KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	28
6.1. Konkluzionet	28
6.2. Rekomandimet.....	28
7 REFERENCAT	31
7.1. Legjislacioni	31
7.2. Raportet, dokumentet dhe statistikat	31
7.3. Intervistat	33

7.4. Të tjera.....	33
8 SHTOJCAT.....	34

FJALORI I TERMAVE

PAT	Preferencat Autonome Tregtare
CEFTA	Marrëveshja për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore
BE	Bashkimi European
EUR	Euro
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
GSP	Sistemi i Përgjithësuar i Preferencave
GDP	Bruto Produkti Vendor
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
SHATK	Shoqata e Turizmit Alternativ në Kosovë
KOTAS	Shoqata e Turizmit në Kosovë
DTZHE	Drejtoria e Trizmit dhe Zhvillimit Ekonomik
KPEP	Projekti për Ndërmarrjet Private të Kosovës
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
PRO IN	Shoqata e Turizmit PRO IN ZHER Zhvillimi Ekonomik Rajonal
AZHR	Agjencia e Zhvillimit Rajonal
SIDA	Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar
OJQ	Organizata Jo - Qeveritare
RrOK	Rrjeti i Organizatave të Kulturës

1 HYRJE

Turizmi si një fenomen masiv social dhe ekonomik ka gjetur reflektimin e tijë në dekadat e fundit. Në këtë periudhë të shkurtër kohore, turizmi është zhvilluar në një nga tiparet më të gjëra sociale të njerëzimit modern. Në të njëjtën kohë, turizmi është karakterizuar nga një kategori ekonomike shumë komplekse dhe e rëndësishme, me zhvillim jashtëzakonisht dinamik dhe ndryshime të shpejta dhe të thella cilësore dhe kuantitative.

Si një fenomen global ekonomik, turizmi është një industri, që pas industrive të naftës dhe të kimikateve, kontribuon më së shumti në rritjen ekonomike dhe në zhvillimin e ekonomisë botërore. Turizmi ka një ndikim të qartë në agregatet makroekonomikë dhe rrit stabilitetin makroekonomik të ekonomisë kombëtare, duke përshpejtuar në të njëjtën kohë zhvillimin lokal dhe rajonal, dhe rritjen e punësimit. Në këtë punim diplome, dua të potencojë rëndësinë ekonomike të turizmit si një nga përcaktuesit e zhvillimit të ekonomisë kombëtare, me theks të veçantë në Kosovë.

1.1 Efektet ekonomike të turizmit

- promotor në zhvillim ekonomik
- promovues në imazhin e Republikës së Kosovës
- gjenerator i vendeve të reja të punës
- rritjen e nivelit në mes të kërkesës dhe ofertës
- mobilizon kapacitetet prodhuese industriale dhe bujqësore
- mobilizon kapacitetet ndërtimore dhe transportin
- kontribues i mirëqenjës së përgjithshme sociale

Gradualisht, rëndësia ekonomike e turizmit po zë vend primar zhvillimi nga shumë vende. Industria e turizmit po shndërrohet në një potencial të rëndësishëm për të përhapur e promovuar përfitimet ekonomike. Shumë vende dhe destinacione kanë pasur sukses, duke rritur me shpejtësi numrin e vizitorëve. Ndikimet pozitive të zhvillimit të turizmit janë të dukshme në gjenerimet e konsiderueshme të vendeve të punës apo rritjen e të ardhurave nga këmbimi valutor.

Marketingu është edhe mjet primar për të rritur efektet pozitive ekonomike. Sot, teknikat e marketingut po mbeten dominuese edhe në planifikimin e turizmit. Me kalimin e kohës, teknikat e përdorura të marketingut bëhen gjithnjë e më të komplikuar, duke përfshirë konsideratat dhe kuptimin e sjelljeve turistike, segmentimit dhe zgjedhjen e konsumatorit. (Zenelaj, 2013)

Për ndikimet pozitive të turizmit në ekonomi, në publikimet e tyre theksojnë se ndikimet pozitive ekonomike mund të shihen në artikujt dhe në tekstet e përkushtuara për analizat ekonomike të turizmit. Kështu, teknikat e tilla, si multiplikatorët dhe modelet input-output, janë të avancuara. Kjo linjë mendimi kishte për qëllim gjetjen më të mirë, matjen e asaj në të cilën pikërisht turizmi mund të kontribuojë, apo në fakt ka kontribuar në zhvillimin ekonomik të një destinacion. (Wall & Mathieson, 2006)

Një nga shqetësimet kryesore të Getz ishte nxjerrja në pah e ndikimeve negative të turizmit në lidhje me komunitetin pritës. Nga kjo pikë, u bë e qartë se orientimi dhe teknikat e marketingut dhe planifikimit turistik, filluan të ndryshojnë. Kjo formë e paekuilibruar e planifikimit të turizmit (apo promovimit të turizmit), mbetet deri më sot si një mjet dominant planifikimi në shumë vende. (Getz, 2007)

Disa studime të realizuara janë të drejtuara në përcaktimin e fazave dhe modeleve të zhvillimit të turizmit. Këto studime kanë trajtuar marrëdhëniet midis zhvillimit të turizmit dhe komuniteteve pritëse për vlerësimin e ndërveprimeve dhe marrëdhënieve Doxey, I cili propozoi një indeks acarimi (Doxey, 2013). Ky model përbëhet nga 4 hapa: a. eufori (kënaqësi në kontakt), b. apati (indiferencë në rritje me një numër të madh), c. pezmatim, (shqetësim dhe bezdi mbi rritjen e çmimeve, krimin, vrazhdësisë, thyerje të rregullave kulturore), dhe d. antagonizëm (agresivitet i fshehtë dhe i dukshëm për vizitorët).

Sipas modelit të Butler-it të përshkruar në librin e edituar nga Lohmann dhe Panosso Netto për evoluimin e zonave turistike, destinacionet turistike zhvillohen nëpërmjet disa fazash, si përfshirje, zhvillim, konsolidim, stagnacion dhe rënie ose përtëritje. Shfaqja e ndikimeve sociale të komuniteteve bëhet më e rëndësishme kur destinacioni arrin zhvillimin e fazën e konsolidimit. Vëzhgimet dhe vlerësimet në mënyrë të qartë sugjerojnë se ndikimet pozitive dhe negative në komunitetet lokale janë të lidhura ngushtë me zgjerimin e turizmit. Me zhvillimin e turizmit, ndikimet pozitive dhe negative po bëhen gjithnjë e më shumë të

dukshme. Planifikimi i turizmit po fokusohet në mënyrën se si të maksimizohen dhe ndikimet negative ndaj komunitetit të minimizohen apo të zbuten. Po ashtu, Butler ofron një konceptim të rëndësishëm në dinamizmin e konsideratave në zonat destinacion, që të dy marketerët dhe planifikuesit të përdoren në planifikim dhe marketing. Në gjuhën e marketingut, vëmendja përqendrohet në kapërcimin e pengesave të rritjes. Në të njëjtën kohë, planifikimi i turizmit përqendrohet jo vetëm në drejtim të asaj se si të zgjasin fazën e rritjes në një destinacion, por edhe lidhur me vlerësimin e burimeve turistike në mënyrë që të identifikojë normat e dëshirueshme dhe format e pranueshme të ndryshimeve në mjedisin dhe në perceptimin e banorëve vendës për zhvillimin e turizmit. *(Lohmann G. & Panosso Netto A., 2017)*

Ky rivlerësim i marrëdhënies së turizmit me komunitetet mikpritëse paraqet sfida të konsiderueshme për industrinë e turizmit dhe planifikuesit e turizmit dhe ka çuar në një thirrje të fortë për të aplikuar një metodë të planifikimit të integruar.

Studiuesit në fushën e turizmit, bënë të qartë se një planifikim i mirë i turizmit duhet të përfshijë përfitimet në të gjitha aspektet e komunitetit, duke përfshirë aspektet sociologjike (p.sh. promovimin e stabilitetit të komunitetit, solidaritetit të familjes, identitetit kulturor), ekonomik (p.sh. punësimin, të ardhurave), mjedisore (p.sh. mbrojtjes / ruajtjes). *(Sharpley & Telfer, 2002)*

Po kështu është argumentuar që komuniteti do të përfitojë më shumë nga zhvillimi i turizmit në qoftë se komuniteti merr pjesë plotësisht në marrjen e vendimeve që ndikojnë në mirëqenien e tyre dhe në zbatimin e këtyre vendimeve. Prandaj, në procesin e planifikimit dhe vendimmarrjes duhet të kërkohet përfshirja e banorëve lokalë në secilin hap.

2 SHQYRTIMI I LITERATURËS

Veprimtaria e turizmit si një fenomen masiv social - ekonomik, ka gjetur reflektimin e tij në disa nga dekadat e fundit në tërë rruzullin tokësor. Përgjatë kësaj periudhe të shkurtër kohore, turizmi është zhvilluar me një intenzitet marramendës dhe shëndrruar në një nga tiparet më të gjëra sociale të njerëzimit modern. Në të njëjtën kohë, turizmi është karakterizuar nga një kategori ekonomike shumë komplekse dhe e rëndësishme, me zhvillim jashtëzakonisht dinamik dhe ndryshime të shpejta dhe të thella cilësore dhe kuantitative, duke mbuluar gadi të gjitha sferat e zhvillimit shoqëror të një vendi, dhe jo vetëm. *(Zenelaj, 2013)*

Fenomeni i turizmit, i cili me këtë emër është paraqitur kah mesi i shek XIV e përcjell zhvillimin e tërësishëm të njeriut. Turizmi në format e veta përcjell edhe mbizotëruesit shoqëror edhe të gjitha formacionet e mëtutjeshme shoqërore të manifestuar tek njerëzit të cilët e plotësojnë kohën e lirë, përmes epokës së turizmit, prej klasës primitive, deri tek turizmi i sotëm bashkëkohor.

Termi “turizëm” më herët është paraqitur në literaturën angleze, që më pas të paraqitet edhe në literaturën franceze, ndërsa rëndësia e vërtetë e tij është vërtetuar para 150 viteve me qëllim që kah gjysma e dytë e shek XIV të ketë përdorim të përgjithshëm. Për kuptimin turizëm përdoren shumë shprehje siç janë “qarkullimi me njerëz”, “qarkullimi me të huajt”, “pranimi i të huajve dhe turistëve”, “turizmi aktiv”, “turizmi receptive”, etj. Megjithatë të gjitha shprehjet e përdorura deri më tani nuk i plotësojnë aktivitetet polivalente të cilat i përfshin në vete turizmi sikur një dukuri e përbërë dhe dinamike. *(Prof. Dr. Krasniqi, 2013)*

Turizmi si kategori ekonomike për zhvillim të qëndrueshëm, së bashku me zhvillimin dhe ndryshimet të ekonomisë botërore në strukturën e veprimtarisë dhe pjesëmarrjen e sektorëve të veçantë në GDP (gross domestic product / produkti i përgjithshëm vendor), të ardhurat kombëtare dhe punësimin e fuqisë punëtore. *(Ministira e Tregtise dhe Industrise, KS & Ceku, 2014)*

Trendet e zhvillimit të turizmit edhe më tej janë në rritje, përderisa Kosova nuk ka të dhëna statistikore, qoftë nga ndonjë burim vendor apo ndërkombëtarë, se sa turizmi është duke

ndikuar në zhvillimin ekonomik të saj dhe cili është impakti i tijë në ekonominë kosovare. *(Kryeministria e Kosoves, 2014)*

Ndikimi i turizmit në ekonominë lokale, është një gamë e gjërë e fushave dhe veprimtarive me kompetencë të sektorit të turizmit, të cilat duhen mobilizuar dhe kanë ndikim të drjetpëdrejt në zhvillim ekonomike lokal të komunës së Prizrenit.

*(Kryeministria e Kosoves, 2014)*të Prizrenit dhe mundësitë që krijohen për një zhvillim sa më të mirë ekonomik. Njohës të kësaj fushe thonë se Prizreni si qytet i lashtë historikë dhe rrethina e tij me pasuri të mrekullueshme natyrore, mund të vlerësohet si vendi me pasuri më të madhe të trashëgimisë natyrore dhe asaj kulturo-historike në rajonin e Ballkanit.

Përmes monumenteve të shumta të trashëgimisë, përfshirë Kalanë, Lidhjen e Prizrenit, Xhaminë e Sinan Pashës, pastaj Hamamin dhe objekte tjera, Prizreni ngërthen në vete histori të shumta. Këtë e kanë pasuruar edhe monumentet e ngritura së fundi kushtuar luftës së fundit. Pos kësaj këtu ka edhe objekte të dy besimeve të tjera, atij katolik dhe ortodoks, të cilat ndodhen në qendër të qytetit, në një distancë jo më të largët se 100 metra nga njëra-tjetra. *(GAP, 2016)*

Sfidë e vazhdueshme e institucioneve lokale mbetet buxheti i mangët për ta subvencionuar zhvillimin lokal të turizmit, ndërtuar kapacitete turistike, përgatitur kapacitetet njerëzore profesionale, si dhe ndërtuar një ambient ligjor miqësor, për zhvillim ekonomik përmes të gjitha formave të turizmit. Kjo për arsye se si kategori relativisht e rezhvillimor dhe ekonomike, kërkon investime të mëdha dhe vazhdueshme, në mënyrë që të mbahet trendi i konkurrencë bërjes me vendet tjera në rajon dhe më gjërë, kur bëhet fjalë për ofrimin e shërbimeve kualitative dhe në kohën e duhur. *(Kryeministria e Kosoves, 2014)*

Përfitimet dhe efektet e turizmit në ekonominë lokale, gjith një duke ndërvepruar ngushtë me sektorët tjerë dhe akterët të cilët janë përgjegjës për zhvillimin ekonomik të vendit, me theks të veçant në rastin tonë Komunën e Prizrenit janë...

Përfitimet më të dukshme nga turizmi tek ata entitete në industrinë e turizmit që drejtpërdrejt shesin shërbime për turistët:

- A. Efektet ndaj atyre pjesëmarrësve në industrinë e turizmit që janë më pak të dukshme - indirekte,
- B. Efektet shumëzuese,
- C. Efektet në të ardhurat e shtetit dhe të ardhurat e komunitetit lokal që rrjedhin nga taksat turistike,
- D. Efektet që turizmi ka në eksportin e produkteve vendase,
- E. Efektet në ndërtimin e një imazhi pozitiv të Republikës së Kosovës. *(IPVQ, 2004)*

Bazuar në analizën e strategjisë afatmesme të zhvillimit të turizmit të rajonit jug, dhe në plani zhvillimor të komunës së Prizrenit 2013 - 2025, si dhe indikatorëve të tjerë turistik dhe ekonomik, mund të konkludohet se turizmi ka gjasa të bëhet një sektor udhëheqës gjatë dekadës së ardhshme, duke kontribuar kështu në rritjen ekonomike, gjenerimit të vendeve të reja të punës dhe të prosperitetit social në rajon. Në këtë kontekst, synimet afatgjata të zhvillimit të turizmit si kategori ekonomike me trende të vazhdueshme rritjeje, do:

- a. Të stimulojë rritjen e vazhdueshme të ekonomisë lokale përmes tërheqjes së investimeve në sektorin e turizmit dhe sektorët tjerë të cilët ndërveprojnë me të,
- b. Të shfrytëzojë kapacitetet e ekonomisë lokale edhe si destinacion turistik,
- c. Të sigurojë që Prizreni të jetë destinacion kryesor turistik në Kosovë,
- d. Të sigurojë qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e rritjes së sektorit të turizmit, *(ASK, 2012)*

Mbështetur bashkarisht në të gjeturat e shumëta dhe analizat e bëra gjatë hartimit të këtijë punimi diplome, dhe rekomandimet të cilat dalin nga dokumentet e ndryshme strategjike, raportet qofshin ato qeveritare, nga biznesi apo nga organizatat joqeveritare sic është Ec më ndryshe. Mund të nxjerrë një gamë të gjërë rekomandimesh, të cilat do të mund ti kontribuonin përmirësimit të gjendjes së zhvillimit lokal ekonomik, duke e përdorur turizmin si instrument

të fuqishëm zhvillimor, me ndikime të ndjeshme në zbutjen e papunësisë, rritjen e zhvillimit ekonomik lokal, trende positive të zhvillimit të prodhimtarisë dhe që është më me rëndësi, rritjes së ndjeshme të mirëqenjes së qytetarëve të komunës së Prizrenit, por jo vetëm atyre. Më poshtë po e paraqes një listë me rekomandime, të cilat potencialisht do të mund të bëjnë ndryshime positive në sektorin e turizmit dhe me këtë edhe përmirësimin e gjendjes ekonomike të komunës së Prizrenit, duke synuar gjithnjë shtrirjen në tërë Republikën e Kosovës:

- I. DTZHE - drejtorja e turizmit dhe zhvillimit ekonomik duhet të bëjë plane operacionale një (1) vjeçare të punës,
- II. Turizmi të jetë ndër objektivat prioritare të Strategjisë dhe Planeve Strategjike të Komunës së Prizrenit,
- III. Të krijohet Këshilli për Zhvillimin e Turizmit në komunën e Prizrenit,
- IV. Të hapen dhe funksionalizohen zyrat informative në Prizren dhe Prishtinë,
- V. Të zhvillohen programe ndërkufitare për zhvillimin e turizmit me shtetet dhe qytetet shqiptare dhe ballkanike,
- VI. Të krijohen guida dhe ekspansione të kombinuara turistike të cilat do të mundësonin turistit të qëndrojnë më gjatë në Prizren,
- VII. Të dizajnohen projektet prioritare për zhvillim të turizmit lokal që ndikojnë në ekonominë e qytetit të Prizrenit,
- VIII. Të përfshihen në buxhet dhe të aplikohet në EURED dhe IPA, si dhe fonde të tjera
- IX. për ndërtimin e objekteve të sportit si Qendra Pedagogjike Sportive, Pishina e Mbyllur Olimpikë e Notit, Qendra e Patinazhit etj.,
- X. Qeveritë qofshin ato lokale apo qendrore mund të promovojnë mundësitë e turizmit nga diaspora duke ulur koston e udhëtimit/fluturimeve për të inkurajuar vizita më të shpeshta nga ta,
- XI. Ngritje e ofertës kulturore, sportive në muajt kur vizita e mercimtarve arrijn maksimumin,
- XII. Organizim të takimeve direkte me përfaqësues të diasporës duke ofruar dhe mundësinë e investimeve nga ana e tyre,
- XIII. Organizim dhe programim të garave për ecje malore në të gjitha stinë,

- XIV. Të organizohet panair i Turizmit me karakter kombëtar në fluksin më të madh të ardhjes nga Diaspora,
- XV. Komuna duhet të rris fondin për organizime kulturore në fokus të veçantë,
- XVI. Komuna në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe akterë tjerë relevant duhet të inicioj debat lidhur me intervenimet e duhura në pjesën urbane të vjetër të qytetit. Rrugicat me kalldrëm, arkitektura e vjetër e shtëpive dhe futja në mbrojtje e shtëpive të vjetra të identifikuar janë çështje të cilat e rrisin ofertën turistike,
- XVII. Organizim tradicional i panairit të artizanaleve,
- XVIII. Organizim i punëtorive apo kolonive të artizanatlinjve me karakter ndërkombëtar.
- XIX. Prodhuesit e vegjël duhet të organizohen në një formë shoqate apo cooperative për të mbrojtur prodhimin, siguruar tregun dhe mbrojtur interesin e tyre në përgjithësi,
- XX. Komuna duhet të bëjë përpjekje që ti koncentroj artizanatlinjtë në një hapësirë ekspozuese dhe shitëse me një adresë permanente për ta,
- XXI. Të filloj programi i Brendimit të produkteve artizanale duke ofruar informacion të duhur për origjinalitetin, historinë dhe rëndësinë kulturore të produktit.
- XXII. Të përgatitet rregullativa për shpallje si zonë me interes të veçantë si rezervati biosferik Lumbardhi dhe Drini i Bardhë,
- XXIII. Të identifikohen të gjitha asetet relevante të trashëgimisë natyrore, kulturore dhe historike, si dhe gjithë infrastruktura tjetër që përfshihet në zhvillim të mëtutjeshëm të rezervatit,
- XXIV. Komuna duhet të ngris fondin e mbështetjes së klubeve sportive në fokus të veçantë organizimin e garave ndërkombëtare.

3 DEKLARIMI I PROBLEMIT

3.1 Turizmi si kategori ekonomike për zhvillim të qëndrueshëm

Së bashku me zhvillimin dhe ndryshimet të ekonomisë botërore në strukturën e veprimtarisë dhe pjesëmarrjen e sektorëve të veçantë në GDP - gross domestic product (produkti i përgjithshëm vendor), të ardhurat kombëtare dhe punësimin e fuqisë punëtore.

Në dyzet vitet e fundit, ndryshime të mëdha strukturore në ekonominë globale janë reflektuar në një tendencë në rritje të shërbimeve, në një pjesë të rëndësishme të sektorit terciar të ekonomisë (tregtisë, turizmit, sigurimin, transportin, bankare, financave, arsimit, inxhinieri, etj). Nuk ka pothuajse asnjë shtet, ekonomia e të cilit nuk ka një pjesë të konsiderueshme të sektorit të shërbimeve.

Në këtë mënyrë, për ekonomitë e vendeve të zhvilluara të mesme dhe më pak të zhvilluara, shërbimet paraqesin një mundësi të rëndësishme për përfshirje më serioze në ndarjen ndërkombëtare të punës. Në gjithë këtë, turizmi zë një vend të rëndësishëm, si një nga industritë më profitabile dhe më të mëdha në botë. Pavarësisht nga situata e pasigurtë politike dhe e sigurisë në botë, si dhe nga kriza ekonomike, pritet një rritje e përgjithshme e tendencave të turizmit, si dhe efektet ekonomike të turizmit.

Turizmi është bërë një fenomen social që karakterizon epokën tonë dhe në gjysmën e fundit të shekullit karakterizohet nga dinamizmi dhe masovizimi. Në fakt, në trendet ndërkombëtare të turizmit në vitin 2015 është arritur një rekord prej 1.2 miliardë \$ të ardhurash (në fakt 1186000), e cila është 50 milion ose 4.4 për qind më shumë se vitin e kaluar.

Trendet e zhvillimit të turizmit edhe më tej janë në rritje, por Kosova nuk ka të dhëna statistikore, qoftë nga ndonjë burim vendor apo ndërkombëtarë, se sa turizmi është duke ndikuar në zhvillimin ekonomik të saj dhe cili është impakti i tij në ekonominë kosovare.

Për shembull është theksuar në raportet e burimeve të ndryshme se viti 2015 ishte viti i gjashtë me radhë me rritjen mesatare të të ardhurve në turizmin ndërkombëtarë. Konsumi i realizuar i turistëve ndërkombëtarë në vitin 2015 arrin në 1.26 miliardë dollarë dhe po rritet vazhdimisht. Nëse këto të dhëna krahasohen me ato të vitit 1950 (25.3 milionë pjesëmarrës

në udhëtime turistike ndërkombëtare, me të ardhura prej 2.1 miliardë dollarë), në masën e dukshme fenomeni i turizmit masiv është në rritje e sipër. (ASK A. S., 2016)

Logaritë e industrisë së turizmit përbëjnë 10% të GDP-së botërore, ku shumica e konsumatorëve janë turistë kinezë, dhe pas tyre të ndjekur nga SHBA, si dhe turistët rusë. Se turizmi drejton ekonominë botërore, kjo dëshmohet nga të dhënat se turizmi përfaqëson 30% të eksporteve botërore të shërbimeve, dhe 6% të totalit të eksporteve të mallrave dhe shërbimeve, dhe si një kategori e eksportit në botë ndodhet prapa industritë e naftës, kimike dhe ushqimore.

Në njëzet vitet e fundit shkalla e rritjes së turizmit është dy herë më e lartë se norma e rritjes së GDP, ku të ardhurat nga turizmi i tejkalojnë shërbimet nga shëndetësia, energjia apo bujqësia. Në shumë vende është një nga tre industritë kryesore, duke arritur më të madhin ose duke lëvizur drejt volumit më të madh të tregtisë me pakicë dhe punësimit më të lartë.

Çdo konsumi që gjeneron aktivitetin ekonomik i duhet kushtuar vëmendje makroekonomike, gjë që kjo është pikërisht interesi i shkencës ekonomike në studimin e turizmit, kur është arritur rritja e të ardhurave të ekonomive kombëtare, të vendeve turistike relevante, si pasojë e zhvillimeve të hovshme turistike. Ky ishte gjithashtu një interes për studimin e pasojave ekonomike të zhvillimit të turizmit.

Në fillim pikëpamja e turizmit është bërë për të studiuar pasojat ekonomike të trafikut turistik që solli në sektorët e mikpritjes, transportit dhe tek veprimtaritë e operatorëve turistikë, si dhe agjencive të udhëtimit. Më vonë studimet e turizmit vunë në dukje ndikimin e tij në aktivitete të tjera ekonomike dhe sociale, domethënë në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik. Në këtë mënyrë, turizmi njihet jo vetëm si pasojë e zhvillimit ekonomik, por edhe si faktor i zhvillimit ekonomik.

Funksionet ekonomike të veprimtarisë së turizmit numërojnë një gamë të gjërë dha kanë efekte zingjirorë ndikimi të veprimtarive të cilat e ndihmojnë zhvillimin e qëndrueshëm në një vend. Ndër treguesit ekonomik të cilët mund ti përmendim janë; turizmi si promotor i rëndësishëm në zhvillim ekonomik të një vendi, i cili me efektet e tija të suksesshme në mes tjerash është edhe promovues në imazhin e një vendi dhe të bukurive natyrore të tijë. Efekt tjetër i rëndësishëm i turizmit është efekti gjenerator i vendeve të reja të punës,qoftë për periudha afatgjate punësimi,qoftë për periudha sezonale punësimi,jo vetëm për banorët lokal

por edhe më gjërë. Vetë rritja e kërkesë për fuqi punëtore në mënyrë automatike mobilizon kapacitetet prodhuese industriale dhe bujqësore, mobilizon kapacitetet ndërtimore, infrastrukturën fizike rrugore, hoteliere, gastronomike dhe transportin modern si veprimtari kryesore për zhvillimin e turizmit të suksesshëm. Prandaj efektet ekonomike të turizmit janë kontribues të drejtpërdrejt të sigurimit të një mirëqenje sociale të qëndrueshme të një vendi.
(Komuna e Prizrenit, 2014)

4 METODOLOGJIA

Gjatë hartimit të këtijë punimi diplome, është zbatuar një metodologji tri dimensionale e analizimit të gjendjes së përgjithshme aktuale në sektorin e zhvillimit ekonomik, rëndësinë e turizmit si kategori e rëndësishme ekonomike, dhe si ndikon turizmi si burim potencial për zhvillim ekonomik në Kosovë, me theks të veçant në komunën e Prizrenit.

Analiza SWOT-Forcës (strength), Dobësive (weakness), Mundësive (opportunities), Kërcënimeve (threats) dhe PESTLE-Politike (political), Ekonomike (economic), Sociale (social), Teknologjike (technological), Legale (legal), Mjedisore (Environmental) janë dy instrumente të cilat janë përdorur, për të analizuar gjendjen e përgjithshme socio-ekonomike në komunën e Prizrenit. Më pastaj janë përdorur tri lloje të burimeve të informatave;

- burimet e dorës së parë (hulumtimi dhe intervistimi i drejtpërdrejtë me akterët relevant në sektorin e zhvillimit ekonomik),
- burimet e dorës së dytë (raporte ekonomike, dokumente historike, statistika nga institucionet relevante, pra informata të cilat janë hartuar duke u mbështetur në burimet e dorës së parë),
- burimet e dorës së tretë (informacione të ndryshme nga mediat elektronike, rrjetet sociale, webfaqet e ndryshme, forumet online, gazetatat, revistat etj.).

Fillimisht janë bërë hulumtime të shumta për të arritur deri të informatat e dëshirueshme dhe më pas të njëjtat janë analizuar dhe më tejë strukturuar në këtë punim diplome.

Është hartuar dhe zhvilluar një pyetësor (annex1), për nevoja të grumbullimit të informacionit, i cili ka të bëjë me zhvillimin ekonomik të komunës së Prizrenit, duke e konsideruar turizmin si burim potencial dhe promotor zhvillimi. Instrumentet e grumbullimit të informatave ishin, intervista të drejtpërdrejta me akterët përgjegjës për zhvillimin e sektorit të zhvillimit ekonomik dhe të turizmit, leximi i raporteve të OJQ-Organizata joqeveritare të cilat mirren me zhvillimet në këto dy sektorë, të Drejtorisë komunale për zhvillim ekonomik dhe të turizmit, të komunitetit të biznesit (agjencione turistike, hoteliere, restorane, dyqane ushqimore dhe suveniresh, kompani transporti dhe taxi, etj.).

Si rezultat të kësaj ndërmarrjeje, është finalizuar ku punim diplome, i cili ka për qëllim të dëshmojë se turizmi si kategori ekonomike dhe industri e rëndësishme me trende të rritjes

globale, është instrument i duhur i komunës së Prizrenit dhe Kosovës, për ta nxitur zhvillimin e përgjthshëm ekonomik dhe përmirësuar standardin jetësor të qytetarëve.

5 PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE

5.1 Prezantimi i rezultateve

5.1.1 Turizmi si potencial për zhvillim lokal në Kosovë

Në vitin 1999, derisa Kosova po përjetonte tmerrin e luftës, bota progresive po përpiqej të zhvillonte turizmin nën temën “Ruajtja e trashëgimisë botërore për mijëvjeçarin e ri”. Pak para se të hynim në mijëvjeçarin e tretë dhe derisa dikush po e promovonte rëndësinë e trashëgimisë kulturore për zhvillimin e turizmit, në Prizren shkatërroheshin vlera të rralla të së kaluarës (Lidhja e Prizrenit, shtëpi të vjetra, etj.). Megjithatë, përfundimi i luftës nuk solli me vete edhe përkujdesjen ndaj trashëgimisë kulturore të Prizrenit.

Fatkeqësisht, mund të thuhet se gjendja u përkeqësua. Dhe derisa temat në kalendarin e Organizatës Botërore të Turizmit ndryshonin nga “ekoturizmi” dhe “sporti dhe turizmi” në “turizmi dhe emancipimi i femrës”, Prizrenin, këtë herë me duart tona, po e shkatërronim pa mëshirë. Dhjetë vite rresht të pas-luftës, me një ritëm gradual dhe konstant, anarkitektët e qytetit, ia merrnin një nga një vlerat dhe mundësitë e rralla të Prizrenit për ta zhvilluar turizmin dhe ekonominë lokale. Sot, tëtëmbëdhjetë vjet pas lufte dhe një strategjie perfide për degradimin e vlerave të qytetit, Prizreni numëron momentet e fundit para tjetërsimit të identitetit të vet dhe njëherit lëshon thirrjet e fundit për intervenim dhe shpëtim.

Formula e zhvillimit socio-ekonomik të qytetit është mjaft e thjeshtë: Prizreni nuk ka nevojë për intervenime të mëdha nga jashtë, ose teknologji e industri të reja për zhvillim, por nevojitet një qasje pragmatike për mobilizimin dhe shfrytëzimin racional të potencialit ekzistues të komunës. Duke e gjallëruar jetën kulturore, konservuar dhe promovuar trashëgiminë kulturore dhe mbrojtur natyrën dhe ambientin, Prizreni do ta ngrisë ofertën e tij kulturore. Kjo do ta shndërrojë qytetin dhe fshatrat e komunës në atraksione të vërteta për turistin botëror, njëherit duke shërbyer si katalizator i krijimit të vendeve të reja të punës, rritjes së të ardhurave për biznesin e vogël dhe të mesëm dhe pasurimin e arkës së komunës.

Turizmi kulturor dhe natyror përbën ndërmarrjen më efikase dhe rrugën më të shpejtë drejt zhvillimit lokal ekonomik të Prizrenit. Kjo mund të arrihet nëse vehtet në jetë bashkëpunimi qeveri lokale - komunitet i biznesit - shoqëri civile - komuniteti në përgjithësi. Me këtë qasje, Prizreni mund të shndërrohet në kryeqytet të kulturës, jo përmes platformave dhe ideve të shkruara në letër, por përmes zhvillimit në praktikë të një jete të pasur kulturore. Mbi të gjitha përmes një organizimi të strukturuar gjatë stinëve të ngrohta dhe me aktivitete me karakter ndërkombëtar, Prizreni mund të shndërrohet në kryeqytet rajonal të kulturës. Këtë nivel qyteti do ta arrijë edhe përmes bashkëpunimit me Festalet Verore të Ohrit, Stambollit, Sarajevës dhe Tiranës, duke u dëshmuar kështu edhe në praktikë se është njëri ndër qytetet më të rëndësishme të kësaj rajoni të Ballkanit. (*Ministira e Tregtise dhe Industrise, KS & Ceku, 2014*)

5.2 Pasqyra e turizmit në Kosovë

5.2.1. Shoqatat afariste të turizmit

Në Kosovë ekzistojnë dhe veprojnë disa shoqata të turizmit. Shoqata e Turizmit të Kosovës (KOTAS) është shoqatë jofitimprurëse, joqeveritare, e themeluar nga individë me qëllim që të mbështesin zhvillimin e turizmit me interes të përbashkët dhe sektorët, programet dhe nismat e saj të lidhura të zbatuara në të gjitha nivelet në Kosovë. Drejt qëllimit të saj për ta mbështetur zhvillimin e industrisë së turizmit në Kosovë dhe përmbushur qëllimet e parapara të saj, KOTAS bashkëpunon dhe bashkërendon aktivitetet e saj me shoqatat dhe organizatat e tjera turistike, si në Kosovë ashtu dhe jashtë vendit. Shoqata e Turizmit Alternativ në Kosovë (SHATK) është shoqatë jofitimprurëse e turizmit e krijuar kohëve të fundit, që ka për qëllim të kontribuojë në zhvillimin e sektorit të turizmit në Kosovë. SHATK është e angazhuar fuqishëm në përmbushjen e objektivave kryesore të saj për zhvillimin e turizmit rural, kulturor dhe malor; bashkërendimin e aktiviteteve ndërmjet operatorëve turistikë, agjencive të udhëtimit dhe hoteleve; ruajtjen e trashëgimisë kulturore; luftimin e cenueshmërisë së investimeve të huaja në sektorin e turizmit; dhe organizimin e aktiviteteve të ndryshme duke përfshirë panairë të turizmit, konferenca të turizmit dhe trajnime. Aktualisht, SHATK-(shoqata e agjencioneve turistike të Kosovës) është i përbërë nga 146

anëtarë - kryesisht hotele, agjenci turistike, operatorë turistikë, kompani transporti, ekspertë individualë të turizmit dhe institucione të tjera – dhe bashkërendon Këshillin e Hoteleve të Kosovës. Shoqata e Turizmit e rajonit jugor është një nismë e përbashkët ndërmjet Agjencisë për Zhvillim Rajonal në Jug dhe Komunës së Prizrenit. Kjo shoqatë ofron shërbime për subjektet turistike duke organizuar një forum për këmbim dhe avokim për trajtimin e sfidave me të cilat përballen bizneset. Në të njëjtën kohë, shoqata ofron shërbime për ngritjen e kapaciteteve që kanë për synim zhvillimin e bizneseve lokale duke forcuar kapacitetet e tyre profesionale dhe integruar turizmin në agjendat e zhvillimit ekonomik lokal. Vëmendje e veçantë i është dhënë shkëmbimit të përvojave me homologët në rajon në fushën e gastronomisë, hotelerisë, udhërrë - fyesve, verërave dhe të ngjashme. Përveç kësaj, shoqata siguron mjete për zhvillimin e turizmit rural duke angazhuar komunitetin në ofrimin e shërbimeve për vizitorët. Shoqata PRO IN-(Shoqata hoteliero turistike promovim dhe integrim) është themeluar më 2012 dhe synimi i saj është promovimi i ushqimeve dhe pijeve vendore. Ajo është aktive në patentimin e këtyre produkteve, si dhe në ngritjen e kapaciteteve të stafit të hoteleve dhe restoranteve. Ajo ka 2,500 anëtarë individualë dhe 120 biznese nga të gjitha pjesët e Kosovës. Shoqata po bën përpjekje të krijojë një bashkëpunim të strukturuar me qeverinë lokale e qendrore të Kosovës, parakusht i domosdoshëm ky për trajtimin e sfidave me të cilat përballen bizneset përkatëse. (*Ministira e Tregtise dhe Industrise, KS & Ceku, 2014*)

5.3 Perspektiva e zhvillimit të turizmit në Kosovë

Zhvillimet turistike në botë po pësojnë transformime hapësinore dhe cilësore, duke u shëndrruar në një industri mjaft fitimprurëse. Çdo ditë e më shumë po zgjerohen destinacionet turistike. Zona pritjeje po bëhen qendrat turistike dikur më të panjohura dhe të arritura me vështirësi. Rajoni i Ballkanit, sidomos në dekadën e fundit po pëson transformime turistike mjaft pozitive. Këto transformime shoqërohen me ndryshime sociale dhe ekonomike, me pasoja pozitive dhe negative.

Përballë këtyre transformimeve, është më se e qartë se ecjet në fushën e turizmit janë mjaft të shpejta dhe përfshijnë segmente të gjëra të jetës së njerëzve, kudo në botë. Zhvillimet

turistike në përgjithësi kanë dy komponentë: kohore dhe hapësinore. Nëse të dy këto komponentë i shikojmë në kontekstin e zhvillimeve në Kosovë, atëherë konstatojmë se këto zhvillime, ndonëse të vonuara në këtë rajon, patjetër që do të përfshijnë edhe Kosovën. Flukset turistike, ndonëse jo të mëdha, gjithsesi janë më të larta se në vitet 80-të dhe 90-të të shekullit të kaluar. Këto zhvillime turistike të lidhura me qarkullime të dyanshme (në drejtim të Kosovës dhe të kosovarëve në drejtim të rajonit dhe më gjerë), shoqërohen me ndryshime dhe pasoja, si: ekonomike, sociale, të vendbanimeve, ambientale, etj. Në varësi të potencialeve turistike, çfarëdo qofshin ato edhe prurjet e reja të turistëve do të kenë orientime në hapësirë. Këto potenciale të çmuara kërkojnë interesim, përkujdesje dhe shfrytëzim racional. Në përpjekje për të realizuar nevojat qytetare, janë duke u funksionalizuar institucionet e vendit, publike e private, të tjera dhe turistike, pra zhvillim i mëtejshëm i kapaciteteve për tu përballë me sfidat e ndryshme në këtë sektor të rëndësishëm ekonomik, social, kulturor etj. Sido që të jetë, kjo kërkon kohë dhe angazhim profesional, i cili nuk është i lehtë të bëhet. Sistemi arsimor në Kosovë, ngjashëm me atë rajonal ka deficitet e tij, të cilët duhet tejkaluar për t'i ardhur në ndihmë dhe për t'ju prirë nevojave të tregut. Në rrethanat aktuale ky segment në shoqërinë kosovare ka defekte. Këto dhe aspekte të tjera në vazhdim janë të lidhura ngushtë me zhvillimin turistik të vendit, për të cilin ky punim synon të kontribuojë. *(Ministira e Tregtisë dhe Industrisë, KS & Ceku, 2014)*

Vlerësimi i potencialeve primare turistike: gjeografiko-natyrore dhe gjeografiko-kulturore, vlerësimi i potencialeve sekondare dhe analizimi i potencialeve terciare janë qasje e duhur për analiza turistike të çdo studimi. Aspekte të raporteve të potencialeve dhe kapaciteteve si dhe mënyrës për shfrytëzim të tyre në Kosovë dhe me theks të veçantë në Prizren, përbëjnë një objektiv të këtij punimi. Adresimet e problemeve me të cilat ballafaqohen potencialet turistike të vendit, qasja ndaj tyre, kapacitetet profesionale, mbrojtja dhe inventarizimi i tyre etj., janë po kështu qëllim më vete që kërkojnë për tu shqyrtuar.

Kapacitetet turistike në Kosovë kanë kronologjinë e vet. Ndonëse me luhate të ndryshme për shkak të rrethanave politike dhe socio-ekonomike të kohës, ato sot lënë për të dëshiruar. Zhvillimet turistike në Kosovë nuk janë të izoluar. Ato varen dhe përcjellin zhvillimet rajonale. Aty edhe Kosova jep ndikimin e saj në këto zhvillime. Sa është ndikimi rajonal mbi Kosovën dhe sa forcë reflektuese ka Kosova, kjo është një qështje e cila kërkon sqarim. I tërë

ky zhvillim në sektorin e turizmit si do të reflektohet në zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe të Prizrenit. Në këto dhe pyetjet tjera do të mundohemi ti japim përgjigje përmes këtijë punimi diplome.

5.4 Roli i turizmit në zhvillimin ekonomik në qytetin e Prizrenit

Turizmi është një nga veprimtaritë më komplekse të shoqërisë së sotme moderne si në vendet e zhvilluara, ashtu edhe në disa shtete në tranzicion siç është Kosova. Turizmi konsiderohet kudo si një nga veprimtaritë me zhvillim më dinamik, pasi në përgjithësi për të ka një treg me kërkesa mjaft të larta dhe gjithmonë në rritje, duke përbërë njëherit edhe një burim të rëndësishëm të të ardhurash dhe punësimi. Zonat më të pëlqyeshme nga turistët zakonisht janë vendet bregdetare, pranë maleve ose qytetet me një histori të vecantë (qendrat historike).

Kosova nuk ka det brenda kufijve të vet, por ajo ka mjaft resurse cilësore turistike. Ato ofrojnë mundësinë e turizmit dimëror dhe malor, atij rekreativo-sportiv, turizmit kulturor të bazuar në trashëgiminë tonë të bollshme historiko-kulturore.

Destinacion i rëndësishëm në Kosovë është pikërisht qyteti i Prizrenit. Turizmi në qytetin e Prizrenit është burim i rëndësishëm, potencial dhe gjenerator i mundshëm i punësimit, zhvillimit dhe mirëqenies. Qyteti i Prizrenit i cili shtrihet në skajin më jugor të Kosovës me një histori të lashtë, karakterizohet nga potenciale të shumta natyrore dhe historiko-kulturore të cilat kanë ndikuar në zhvillimin e turizmit. Por zhvillimi i turizmit kërkon që paraprakisht të plotësohen disa parakushte dhe ndër to më me rëndësi është infrastruktura e zhvilluar e qytetit.

Prandaj, integrimi rajonal dhe aspekte të rëndësishme pozitive të globalizimit duhet të inkludohen domosdoshmërisht në sferën e turizmit, që mund të shndërrohet në degë shumë fitimprurëse të ekonomisë së Prizrenit dhe të vendit.

5.5 Karakteristikat ekonomike të qytetit të Prizrenit

Ndërmarrjet private në komunën e Prizrenit janë të bazuara në agrikulturë, tregti, ndërtimtari dhe prodhimin e produkteve ushqimore. Bizneset private në të shumtën e rasteve kanë

vështirësi në sigurimin e investimeve kapitale, si nga entitetet lokale, ashtu edhe nga ato të huaja. Problematikë shtesë është konkurrenca e produkteve nga Serbia, Shqipëria, Turqia dhe Kina, të cilat e dominojnë tregun. Për shkaqe të vështirësive financiare, disa kompani janë mbyllur, ndërsa të tjerat po e reduktojnë numrin e të punësuarve. Rënia ekonomike po kontribuon drejtpërsëdrejti në ngritjen e shkallës së papunësisë dhe me këtë, edhe të shkallës së varfërisë. Strategjitë ekonomike pritet të orientohen në turizmin kulturor, panoramik, rural dhe të ngjashme. Pothuajse i gjithë prodhimi i agrikulturës dhe blegtorisë është në duart e privatëve, biznese joformale dhe në shkallë të vogël.

Në Prizren dhe komunë veprojnë 9 banka përmes degëve të tyre si ProCredit (PCB), Raiffeisen (RBK), Banka Ekonomike Turke (TEB), Nova Ljubljanska Banka (NLB), Banka Private e Biznesit (BPB), Banka Ekonomike, Banka Kombëtare Tregtare (BKT), Zirat Bank dhe Ish Banka. Gjithashtu shërbimet e veta i japin edhe institucionet mikro financiare si FINCA, KEP etj. Llogaritet se Komuna e Prizrenit ka të punësuar rreth 21.499 persona. Prej tyre 12.371 janë të punësuar në sektorin privat dhe 4.341 në sektorin shoqëror dhe 4.787 në sektorin publik. Shumica e të punësuarve punojnë në sektorin industrial (41%), tregti me shumicë dhe pakicë (24.6%), shërbime (20%) dhe ndërtim (13.4%). Rreth 60% e banorëve të komunës së Prizrenit jetojnë në viset rurale dhe të ardhurat i fitojnë nga aktivitetet bujqësore. Sektori i bujqësisë dhe i blegtorisë siguron një kontribut të madh në prodhimin e brendshëm bruto të komunës, e pasur me burime të shumta bujqësore, ku përgjatë shekujve ka prodhuar lloje të ndryshme të drithërave, rrushit, pemëve dhe perimeve. Komuna e Prizrenit ka potencial të madh për zhvillim të turizmit, duke marrë parasysh pozitën gjeografike, malet piktoreske të Sharrit, kushtet klimatike të përshtatshme dhe pasuritë e trashëgimisë së lashtë kulturore. Mikpritja e ngrohtë, e shoqëruar me ushqimin e shijshëm tradicional prizrenas, mund të haset në çdo kënd të qytetit të Prizrenit dhe përgjatë luginës së Lumbardhit dhe të Zhupës, ku mund të përjetohen çaste nga më të bukurat të ofruara nga mikpritja zemërgjerë e hotelierëve prizrenas. *(Komuna e Prizrenit, 2014)*

5.6 Ekonomia - Infrastruktura dhe Mjedisi i Biznesit në komunën e Prizrenit

5.6.1. Korniza themelore e zhvillimit ekonomik të Komunës së Prizrenit është aktivizimi i plotë i Parkut të Biznesit i cili ndodhet në pjesën verilindore të qytetit të Prizrenit në

lokacionin e që shtrihet në boshtin rrugor Lubizhdë – Korishë, në largësi 5 km prej qytetit. Në kuadër të kësaj zone gjendet e ndërtaur rruga regjionale në drejtim të Prishtinës. Kjo hapësirë për këtë destinim është e rregulluar sipas vendimit të Kuvendit Komunal të Prizrenit e që do të trajtohet si zonë e zhvillimit të ekonomisë së vogël dhe të mesme. Puna e arritur deri më tani në përgatitjen e këtij parku është në fazën përfundimtare dhe kërkesat kanë të bëjnë me mundësinë e të shfrytëzuarit sa më ekonomikisht dhe efektivisht tokën brenda kësaj hapësire, dhe joshjen e bizneseve sa më të mëdha për të arritur numër më të madh të punësuarish.

Gjatë viteve të fundit, Prizreni është duke vendosur themelet e një ekonomie të orientuar në treg dhe duke u përpjekur për ta zhvilluar sektorin e prodhimit të vendit. Në të kaluarën e afërt Prizreni ishte simbol i zëjtarisë dhe ekzistojnë përpjekje të mëdha që ta mbajë këtë epitet. Prizreni si e gjithë Kosova ka nivele shumë të ulëta të raportit eksport/import. Megjithatë, sektori industrial i ekonomisë rajonale shfaq përparim të moderuar gjatë disa viteve të fundit. Janë themeluar një numër i madh i kompanive të reja dhe kanë filluar të operojnë në sektorë të ndryshëm, veçanërisht në sektorin e ushqimit. Kompanitë e reja bazohen në iniciativën lokale dhe shumë ulët në ndonjë investim të huaj. Një kompani Holandeze është shembull i parë i investimit të përbashkët ndërmjet një ndërmarrjeje nga Diaspora dhe një investitori të huaj. Planet komunale në krijimin e parqeve komunale/industriale/ dhe atyre për biznes kanë kaluar fazat fillestare të realizimit.

Sipas Agjencionit të Statistikave të Kosovës, diku rreth 8.000 biznese janë regjistruar dhe ky numër vazhdon të rritet. Shkalla e shuarjes së bizneseve (kompanitë që dalin nga biznesi) gjatë disa viteve të fundit ka qenë 8%, mirëpo kjo është kompensuar nga përqindja e bizneseve të reja fillestare. Krahasimi i numrit të bizneseve të regjistruara, me numrat që kanë të bëjnë me punësimin shpie drejt konkluzionit që brenda sektorit privat rritja ekonomike e Rajonit është kryesisht e drejtuar nga Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM – të) dhe jo nga numri i vogël i bizneseve të mëdha.

Rritja ekonomike është kryesisht e nxitur nga sektori privat, edhe atë në masën më të madhe nga bizneset e vogla. (*Komuna e Prizrenit, 2014*)

5.6.2. Prizreni ka një qasje relativisht të mirë në infratstrukturën rrugore lokale dhe regionale, mirëpo probleme të theksuara në lidhje me Maqedoninë, deri në një afat kohorë të përfundimit të autoudhës në ndërtim, e cila e lidhë Republikën e Kosovës me Republikën e Maqedonisë, përmes grykës së Karadakut. Qasja në bregdetin e Shqipërisë arrihet përmes auto-udhës moderne” rrugës së kombit”, e cila kalon përkaj qytetit të Prizrenit.

5.6.3. Qasja në portet dhe aeroportet

Kosova aktualisht ka një aeroport civil ndërkombëtar në Sllatinë të Prishtinës. Aeroporti “Adem Jashari” zhvillon rreth 20 fluturime në ditë dhe është i njohur dhe për transportin e mallërave.

Kosova nuk ka qasje në det dhe portet më të afërta mund të konsiderohen ato të Shqipërisë, si Porti i Durrësit dhe ai i Shëngjinit. Shfrytëzimi dhe kalimi i mallërave realizohet nëpërmjet autostradës “Ibrahim Rugova” që kalon në Morinë-Kukës-Durrës.

5.6.4. Infrastruktura e turizmit-shërbimet

Komuna e Prizrenit kohëve të fundit është duke u marrë aktivisht me turizmin si njërin nga fushat e zhvillimit të komunës së Prizrenit. Komuna ka licencuar 36 ciceronë të cilët kanë ndjekur trajnime strikte dhe të gjithë kanë CV-Curriculum vitale (rrjedha historike jetësore) të shkëlqyer sa i përket kualifikimeve, raporteve ndërnjerëzore dhe karakterit të tyre. Gjithashtu, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit ka trajnuar në detale të gjithë agjensionet të cilët janë aktivisht të involvuar në fushën e turizmit.

Një nga hapat e ndërmarrë të kësaj drejtorie është edhe evidentimi në terren i të gjitha kapaciteteve turistike të Komunës si të trashëgimisë natyrore, e veçanërisht kapacitetet hoteliere dhe shërbyese në turizëm.

Në evidentimin fizik të kapaciteteve hoteliere dhe shërbyese në turizëm janë përfshirë të dhëna detale për secilin subjekt, nga të dhënat e kontaktit, kapacitetet e tyre të punësuarit e

deri të fotografa dhe në fund kanë krijuar bazën e të dhënave e cila synohet të përsoset dhe të zgjerohet në vitin e ardhshëm.

Sipas këtij regjistrimi në komunën e Prizrenit janë gjetur; 35 restaurante; 6 Hotele; 8 Hotele me restaurant; 7 Motele me restaurant, 2 restorante të ushqimit të shpejt të markës botërore KFC, 10 kafeteri, 9 bare, 1 pub; 6 Ëmbëltore, 3 Pastiqeri, 3 Fast Food, 3 Qebaptore; 1 kompleks turistik; 1 kopsht zoologjik; 1 Muze; 25 Agjencione turistike dhe të tjera si furra, burektore, prodhime peshku, bujtinë.

Nga baza e të dhënave të përfaqësuara del që hotelet në Prizren kanë 475 dhoma me një shtrat, dy shtretër dhe tre shtretër, 21 Apartmente, 19 Villa bungalovë, 8 VIP Apartmente, 8 Kthina të Masazhit, 4 Sauna, 5 Sallë Fitnesi, 4 Pishina, 25 Sallë Konferencash, 18 sallon dasmash me një hapësirë prej 6850 m².

Në procesin e inventarizimit të infrastrukturës dhe shërbimeve turistike dhe potencialit lokal turistik të menaxhuar nga drejtoria e turizmit janë evidentuar 17 agjencione turistike me kapaciteti të transportit, të përgjithshëm, në ulëse prej 11077, mbi 90% autobus dhe pjesa tjetër minibus. Poashtu një numër i madh TAXI sh janë të licencuar (dhe të pa licencuar) për ta ushtruar veprimtarinë e tyre dhe kontribuar transportit cilësor në Prizren. *(Komuna e Prizrenit, 2014)*

5.7 Analiza e rezultateve

5.7.1. Si ndikon turizmi në ekonominë lokale

Është një gamë e gjërë e fushave dhe veprimtarive me kompetencë të sektorit të turizmit, të cilat duhen mobilizuar dhe kanë ndikim të drjetpërdrejt në zhvillim ekonomike lokal të komunës së Prizrenit:

- Turizmi Kulturor dhe i Trashëgimisë Kulturore
- Turizmi Malor
- Turizmi për Vizita Familjare/Diaspora
- Turizmi i Vizitave Ditore dhe Tregtare

- Informacioni Turistik
- Turizmi Rural
- Turizmi Natyror
- Infrastruktura
- Kapacitetet Humane
- Kapacitetet Hoteliere, Akomodimi, Ushqimi dhe Pijet
- Brendimi i Shërbimeve
- Promovimi i Turizmit
- Ndërtimi i imazhit të turizmit
- Shërbimet Publike dhe Private
- Transporti Publik dhe Privat
- Suveniret
- Biznesi i vogël dhe i mesëm

5.7.2. Përfitimet të cilat ndikohen nga zhvillimet në sektorin e turizmit në komunën e Prizrenit janë:

- zhvillimi i qëndrueshëm i produktit dhe zbatimi i parimit të qëndrueshmërisë në të gjitha nivelet,
- krijimi i mekanizmave efikas institucional në nivel lokal, te cilat garantojnë zbatimin e planeve dhe objektivave strategjike të zhvillimit të turizmit,
- hartimi apo rishikimi i planeve urbanistike të zonave me prioritet turizmin mbështetur në analiza të plota ekonomike, sociale-kulturore, dhe mjedisore,
- krijimi i një sistemi sipas standardeve ndërkombëtare për grumbullimin dhe shpërndarjen e të dhënave statistikore mbi zhvillimin e kërkesës dhe ofertës,
- zhvillimi i elementeve infrastrukture,
- zhvillimi me prioritet i strukturave akomoduese me kapacitet mesatar deri në 500 dhoma në zonën historike dhe kategori në rritje,
- arsimimi dhe trajnimi i burimeve njerëzore në shërbim të turizmit,

- rritja e financimeve dhe gjetja e skemave rregullatorë në funksion të krijimit të mjediseve tërheqëse,
- rritja e financimeve për mbrojtjen dhe ruajtjen e vendeve me rëndësi natyrore, kulturore dhe të trashëgimisë kulturore,
- mobilizimi dhe angazhimi i sektorit publik/privat,
- marketingu dhe promovimi i turizmit brenda dhe jashtë vendit
- promovimi i praktikave më të mira,
- investimi në burime të ndryshme kritike njerëzore në mënyrë që sektori i turizmit të zhvillohet efektivisht,
- telekomunikacioni dhe interneti janë një komponent i rëndësishëm dhe domosdoshmërisht në rritje për promovimin e sektorit të turizmit dhe komunikimin.

5.7.3. Sa fiton Prizreni nga turizmi

Që nga paslufta dhe këtej, gjithnjë e më shumë është folur për potencialin turistik të rajonit të Prizrenit dhe mundësitë që krijohen për një zhvillim sa më të mirë ekonomik.

Njohës të kësaj fushe thonë se Prizreni si qytet i lashtë historikë dhe rrethina e tij me pasuri të mrekullueshme natyrore, mund të vlerësohet si vendi me pasuri më të madhe të trashëgimisë natyrore dhe asaj kulturo-historike në rajonin e Ballkanit. Përmes monumenteve të shumta të trashëgimisë, përfshirë Kalanë, Lidhjen e Prizrenit, Xhaminë e Sinan Pashës, pastaj Hamamin dhe objekte tjera, Prizreni ngërthen në vete histori të shumta. Këtë e kanë pasuruar edhe monumentet e ngritura së fundi kushtuar luftës së fundit. Pos kësaj këtu ka edhe objekte të dy besimeve të tjera, atij katolik dhe ortodoks, të cilat ndodhen në qendër të qytetit, në një distancë jo më të largët se 100 metra nga njëra-tjetra.

Këto karakteristika, përfshirë këtu edhe zejet e vjetra dhe dyqanet e shumta të argjendarisë, por edhe kulturën e bashkëjetesës midis disa bashkësive etnike kanë bërë që Prizreni të jetë ndër më të vizituarit në vend.

Vlerësohet se Prizreni ka potencial të jashtëzakonshme për zhvillimin e turizmit, jo vetëm gjatë verës, por gjatë 365 ditëve të vitit. Vitet e fundit ndërkaq numri i të huajve, sidomos të njerëzve të artit është shtuar gjatë muajit gusht, kur për një javë mbahet festivali tradicional ndërkombëtar i filmit të shkurtër dhe të atijë dokumentar “Dokufest”.

Autoritet lokale thonë se nuk mund të flasin për ndonjë shifër konkrete rreth mjeteve që vijnë nga veprimtaritë e turizmit, në mungesë të të dhënave zyrtare . (GAP, 2016)

Përkundër mundësive ideale pët të zhvilluar turizmin kulturor, rekreativ, malor edhe turizmin dimëror, deri më tani ka munguar një qasje më e përkushtuar institucionale e mbështetjes nga shteti, për ti zhvilluar kapacitetet e duhura turistike. Malet piktoreske, që e rrethojnë këtë qytet, përbëjnë një potencial të mirë për turizmin dimëror. Prevalla, Malet e Sharrit, të Pashtrikut, etj, paraqesin një mundësi të mirë për turistët dhe dashamirët e eksplorimit të bukurive natyrore. Në këtë kontekst, Komuna e Prizrenit vite më parë bëri hapin e duhur, duke themeluar Drejtorinë për Turizëm dhe Zhvillim Ekonomik (DTZHE), në kuadër të qeverisjesë lokale, e cila ka për qëllim hartimin e strategjive dhe implementimin e politikave publike me qëllim të rritjes së ofertës turistike. (Morina, 2015)

Sfidë e vazhdueshme e institucioneve lokale mbetet buxheti i mangët për ta subvencionuar zhvillimin lokal të turizmit, ndërtuar kapacitete turistike, përgatitur kapacitetet njerëzore profesionale, si dhe ndërtuar një ambient ligjor miqësor, për zhvillim ekonomik përmes të gjitha formave të turizmit.

5.7.4. Faktorët të cilët ndikojnë në zhvillimin e turizmit në komunën e Prizrenit

- Lloji i destinacionit turistik në relacion me karakteristikat e saj natyrore,
- Lloji bazik i produktit turistik i cili i ofrohet tregut,
- Sasia dhe struktura e konsumit turistik,
- Shkalla e zhvillimit të ekonomisë së përgjithshme në vend dhe me theks të veçant në destinacion (komunën e Prizrenit),
- Madhësia dhe lloji i ekonomisë lokale (ajo dominuese shërbyese, prodhuese apo e përzier),
- Shkalla në të cilën konsumi turistik qarkullon në kuadër të ekonomisë lokale (shkalla e importit për prodhime dhe shërbime),

- Shkalla e varësisë së ekonomisë lokale nga sezonaliteti dhe mundësia që të zvoglohet sezonaliteti (pasojat e tyre).

5.7.5. Përfitimet dhe efektet e turizmit në ekonominë lokale

- Përfitimet më të dukshme nga turizmi tek ata entitete në industrinë e turizmit që drejtpërdrejt shesin shërbime për turistët,
- Efektet ndaj atyre pjesëmarrësve në industrinë e turizmit që janë më pak të dukshme - indirekte,
- Efektet shumëzuese,
- Efektet në të ardhurat e shtetit dhe të ardhurat e komunitetit lokal që rrjedhin nga taksat turistike,
- Efektet që turizmi ka në eksportin e produkteve vendase.

5.7.6. Efektet negative të mundshme në ekonominë lokale

- Vartësia e tepërt e ekonomisë lokale në veprimtarinë e turizmit;
- Shpenzimet inflacioniste të ekonomisë lokale kur hapen zona të reja biznesi;
- Rritja potenciale e çmimeve si rezultat i fillimit të një cikli të ri të zhvillimit të turizmit dhe konkurrencës së çmimeve me vendet konkurruese;
- Vartësia e rritjes së importeve dhe mbështetja më e ulët në produktet dhe shërbimet lokale dhe në punë;
- Rreziku i kufizuar individual i investimeve për shkak të sezonalitetit të theksuar;
- Rrjedhja e konsumit turistik nga ekonomia kombëtare nëpërmjet udhëtimit të popullatës së vendit jashtë vendit;
- Kosto shtesë për qeverinë e qytetit që menaxhon turizmin

5.7.7. Ndikimi i drejtpërdrejt i turizmit në ekonominë lokale

- Ndikimi në produktin social dhe të ardhurat kombëtare,
- Ndikimi në zhvillimin e aktiviteteve ekonomike që përbëjnë industrinë e turizmit,
- Ndikimi në bilancin e pagesave,
- Ndikimi në punësimin e popullatës dhe në nivelin e standardit jetësor,

- Ndikimi në aktivitetin e investimeve dhe strukturën e investimeve,
- Ndikimi në zhvillimin më të shpejtë të zonave të pazhvilluara.

6 KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

6.1. Konkluzionet

Bazuar në analizën e strategjisë afatmesme të zhvillimit të turizmit të rajonit jug, dhe në plani zhvillimor të komunës së Prizrenit 2013 - 2025, si dhe indikatorëve të tjerë turistik dhe ekonomik, mund të konkludohet se turizmi ka gjasa të bëhet një sektor udhëheqës gjatë dekadës së ardhshme, duke kontribuar kështu në rritjen ekonomike, gjenerimit të vendeve të reja të punës dhe të prosperitetit social në rajon.

Ndërsa theksi kryesor do të vazhdojë të jetë trashëgimia natyrore dhe kulturore, profili i tregut turistik të rajonit tentohet që të zhvendoset nga një dominim i mdh vizitorësh vendas dhe një-ditor, në një përzjerje të madhe të turistëve nga brenda dhe jashtë Kosovës, me qëndrim më të gjatë. Për të arritur këtë qëllim, është e rëndësishme të arrihet zhvillimi dhe promovimi i produkteve të reja turistike dhe përvojat që do të pasurojnë atraktivitetin e rajonit dhe paraqesin arsye më shumë për të vizituar. Përvojat positive mund të prodhohet nga investimet në shërbime të ofruara në një mjedis të ruajtur mire dhe përmes përmirësimit të shërbimeve turistike të ofruara në një raport efektiv çmim - cilësi.

Në këtë kontekst, synimet afatgjata të zhvillimit të turizmit si kategori ekonomike me trende të vazhdueshme rritjeje, do:

- Të stimulojë rritjen e vazhdueshme të ekonomisë lokale përmes tërheqjes së investimeve në sektorin e turizmit dhe sektorët tjerë të cilët ndërveprojnë me të,
- Të shfrytëzojë kapacitetet e ekonomisë lokale edhe si destinacion turistik,
- Të sigurojë që Prizreni të jetë destinacion kryesor turistik në Kosovë,
- Të sigurojë qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e rritjes së sektorit të turizmit,

6.2. Rekomandimet

1. DTZHE - drejtoria e turizmit dhe zhvillimit ekonomik duhet bëjë plane operacionale 1 vjeçare të punës,
2. Turizmi të jetë ndër objektivat prioritare të Strategjisë dhe Planeve Strategjike të

Komunës së Prizrenit,

3. Të krijohet Këshilli për Zhvillimin e Turizmit në komunën e Prizrenit,
4. Të hapen dhe funksionalizohen zyrat informative në Prizren dhe Prishtinë,
5. Të zhvillohen programe ndërkufitare për zhvillimin e turizmit me shtetet dhe qytetet shqiptare dhe ballkanike,
6. Të krijohen guida dhe ekspansione të kombinuara turistike të cilat do ti mundësonin turistit të qëndroj më gjatë në Prizren,
7. Të dizajnohen projektet prioritare për zhvillim të turizmit lokal që ndikojnë në ekonominë e qytetit të Prizrenit,
8. Të përfshihen në buxhet dhe të aplikohet në EURED- (Instrument i BE për ndihmë financiare) dhe IPA- (Instrumenti i para antarësimit për ndihmë financiare), si dhe fonde të tjera për ndërtimin e objekteve të sportit si Qendra Pedagogjike Sportive, Pishina e Mbyllur Olimpikë e Notit, Qendra e Patinazhit etj.,
9. Qeveritë qofshin ato lokale apo qendrore mund të promovojnë mundësitë e turizmit nga diaspora duke ulur koston e udhëtimit/fluturimeve për të inkurajuar vizita më të shpeshta nga ta,
10. Ngritje e ofertës kulturore, sportive në muajt kur vizita e mergimtarve arrin maksimumin,
11. Organizim të takimeve direkte me përfaqësues të diasporës duke ofruar dhe mundësinë e investimeve nga ana e tyre,
12. Organizim dhe programim të garave për ecje malore në të gjitha stinët.
13. Të organizohet panair i Turizmit me karakter kombëtar në fluksin më të madh të ardhjes nga Diaspora,
14. Komuna duhet të rris fondin për organizime kulturore në fokus të veçantë,
15. Komuna në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe akterë tjerë relevant duhet të inicioj debat lidhur me intervenimet e duhura në pjesën urbane të vjetër të qytetit. Rrugicat me kalldrëm, arkitektura e vjetër e shtëpive dhe futja në mbrojtje e shtëpive të vjetra të identifikuar janë çështje të cilat e rrisin ofertën turistike,
16. Organizim tradicional i panairit të artizanaleve,
17. Organizim i punëtorive apo kolonive të artizanatlinjve me karakter ndërkombëtar.

18. Prodhuesit e vegjël duhet të organizohen në një formë shoqate apo cooperative për të mbrojtur prodhimin, siguruar tregun dhe mbrojtur interesin e tyre në përgjithësi,
19. Komuna duhet të bëjë përpjekje që ti koncentroj artizanatlinjtë në një hapësirë ekspozuese dhe shitëse me një adresë permanente për ta,
20. Të filloj programi i Brendimit të produkteve artizanale duke ofruar informacion të duhur për origjinalitetin, historinë dhe rëndësinë kulturore të produktit.
21. Të përgatitet rregullativa për shpallje si zonë me interes të veçantë si rezervati biosferik Lumbardhi dhe Drini i Bardhë,
22. Të identifikohen të gjitha asetet relevante të trashëgimisë natyrore, kulturore dhe historike, si dhe gjithë infrastruktura tjetër që përfshihet në zhvillim të mëtutjeshëm të rezervatit,
23. Komuna duhet të ngris fondin e mbështetjes së klubeve sportive në fokus të veçantë organizimin e garave ndërkombëtare.

7 REFERENCAT

7.1. Legjislacioni

- Gazeta Zyrtare e Kosovës, *Ligji për taksën e akomodimit në objekte hoteliere e turistike*, 7 janar 2009
- Gazeta Zyrtare e Kosovës, *Ligji për turizmin*, 10 maj 2013
- Republika e Kosovës, *Gazeta Zyrtare, Ligji për patentat*,
- Dokumenti strategjik për zhvillim të turizmit dhe plani i veprimit 2015 - 2020
- Plan i zhvillimor i komunës së Prizrenit 2013 - 2025

7.2. Raportet, dokumentet dhe statistikat

ASK, A. i. (2012). *Seria 3: Statistikat Ekonomike Bruto Produkti Vendor sipas aktiviteteve ekonomike 2006-2012*. Prishtine, Kosove: Agjensioni i Statistikave te Kosoves.

ASK, A. S. (2016). *Agjensioni Statistikave te Kosoves*. Retrieved from Agjensioni Statistikave te Kosoves : <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/ekonomi/hotelet-dhe-turizmi>

Doxey. (2013). *Geography Rocks*. Retrieved from Geography Rocks: <http://www.geographyrocks.org/uploads/2/0/4/2/20422591/doxeys.pdf>

GAP, I. (2016, Mars 1). *Instituti GAP*. Retrieved from Instituti GAP: <http://www.institutigap.org/lajme/790>

Getz, D. (2007). Progress in Tourism Management. Event tourism: Definition, evolution, and research. *Elsevier*.

IPVQ, M. e. (2004). *Zhvillimi i turizmit dhe programi i rregullimit hapësinor të turizmit*. Prishtine, Kosove: Qeveria e Kosoves.

Komuna e Prizrenit. (2014). *DOKUMENTI STRATEGJIK PËR ZHVILLIMIN E TURIZIMIT DHE PLANET E VEPRIMIT*. Prizren. Kosove: Komuna e Prizrenit.

Kryeministria e Kosoves. (2014). *Plani i Veprimit i Vizionit Ekonomik te Kosoves*. Prishtine, Kosove: Kryeministria e Kosoves.

Lohmann G. , & Panosso Netto A. (2017). *Tourism theory: concepts, models and systems*. Nathan, Australia: FAPESP.

Ministira e Tregtise dhe Industrise, KS, & Ceku, H. (2014). *PROFILI I SEKTORIT TË TURIZMIT*. Prishtine, Kosove: Ministria e Tregtise dhe Industrise, KIESA, UNDP.

Morina, Q. (2015, Prill 06). *Prizreni nuk e di sa fiton nga turizmi*. Retrieved from Gazeta Zeri: <http://zeri.info/aktuale/27062/prizreni-nuk-di-sa-fiton-nga-turizmi/>

Prof. Dr. Krasniqi, A. (2013). *E DREJTA NË TURIZËM ME ELEMENTE NGA E DREJTA BIZNESORE*. Universiteti "Haxhi Zeka".

Sharpley, R., & Telfer, D. (2002). *Tourism and Development: Concepts and Issues*. Toronto, Australia: Channel View Publications.

Wall, & Mathieson. (2006). *Tourism: Change, Impacts and Opportunities*. Pearson.

Zenelaj, B. (2013). *Kater qytetet historike Janina, Ohri, Prizreni dhe Gjirokastra. Projekti i financuar nga BE / European Values in Heritage*.

7.3. Intervistat

- Sevil Kazaz, drejtoreshë në Drejtorinë e Turizmit, dhe Zhvillimit Ekonomik të komunës së Prizrenit,
- Nderim Bytyqi, drejtor ekzekutiv i Agjencionit për Zhvillim rajonal, Projekt i BE
- Bajram Basha, udhëheqës i Shoqatës së Turizmit, rajoni jugor,
- Baki Hoti, udhëheqës i Shoqatës së Turizmit Alternativ të Kosovës,
- Eroll Bilibani, Drejtor Ekzekutiv i Dokufest,
- Ares Shporta, kryesues i Rrjetit të organizatave të kulturës në komunën e Prizrenit
- Bariu Zenelaj, Drejtor Ekzekutiv i Academy for Training and Technical Assistance ATTA

7.4. Të tjera

- Marrëveshja për tregti të lirë në Evropën Qendrore
- Agjencia për Promovimin e Investimeve në Kosovë
- Shoqata e Turizmit Alternativ në Kosovë (SHATK)
- Shoqata e Turizmit në Kosovë (KOTAS)
- Komuna e Prizrenit, Drejtoritë
- Përfaqësues i Tregtisë së SHBA-së, produktet e pranueshme në GSP
- Trashëgimia Kulturore pa Kufij, CHwB
- Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ)
- Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, Kosovë

8 SHTOJCAT

PYETËSORI

ANNEX 1

Pyetëtori do të shërbejë ekskluzivisht për qëllime studimore, për realizimin e temës së diplomës:

Turizmi si burim potencial për zhvillim lokal ekonomik në komunën e Prizrenit

Respodenti _____

Pozita e punës _____

Institucioni _____ Formal Jo-formal

Subjekti

Web`i _____

Kontaktet _____

I Pyetjet për komunitetin lokal

1. Sa kohë merreni me Turizëm?

- a) Të gjithë jetën time
- b) Më shumë se 20 vjet
- c) Më pak se 10 vjet
- d) Sa kam filluar

2. Cilat shërbime ose produkte i ofroni për turistët?

- a) Akomodim
- b) Guide/ ciceron turistik
- c) Shërbime shitjesh (shitore)
- d) Restorant
- e) Gatim ushqimi tradicional
- f) Transport
- g) Asnjëherë nga këto

3. A keni kontakte të drejtpërdrejta me turistët?

- a) Po,
- b) Po, sipas nevojës,
- c) Jo, asnjëherë.

4. A keni qenë i përfshirë në hartimin e politikave publike lokale apo ndonjë lloj takimi ku keni diskutuar zhvillimin e turizmit në komunën tuaj?

- a) Po, shumë herë,
- b) Po, së paku dy herë gjatë vitit,
- c) Jo, asnjëherë.

5. A jeni pyetur për mendimin tuaj mbi turizmin nga ata që planifikojnë zhvillimin e turizmit?

- a) Po nganjëherë,
- b) Jo asnjëherë.

6. Ku je informuar për vendimet e mëdha në lidhje me zhvillimin e turizmit në komunitetin tuaj?

- a) Përmes mjeteve të informimit, gjithmonë, ose shumë herë,
- b) Përmes takimeve të organizuara nga komuniteti dhe operatorët,
- c) Përmes miqve.

7. Sa ndikon turizmi në komunitetin tuaj?

- a) Turizmi sjellë ardhura të mëdha për komunitetin,
- b) Turizmi krijon tregje të reja për prodhimet tona vendore,
- c) Krijon vende të reja të punës,
- d) Zhvillimi i turizmit bëhet në harmoni me mjedisin dhe mjedisi është i ruajtur mirë.

8. A mendoni se zhvillimi i turizmit ndihmon zhvillimin ekonomik?

- a) Turizmi kulturor nxit restaurimin dhe konservimin,
- b) Turizmi është katalizator për të zhvilluar ekonomikisht komunën,
- c) Turizmi bashkon grupet e ndryshme brenda komuniës të punojnë së bashku,
- d) Turizmi është një tjetër formë e edukimit për turistët që të kuptojnë dhe të vlerësojnë rrugën e jetën e komunitetit pritës.

II. Operatorët turistikë (hotel, motel, ekonomi familjare, fshat turistik, agjenci turistike)

9. Operatori turistik _____

Subjekti: hotel, motel, ekonomi familjare, fshat turistik, agjenci turistike

Vendi

Lloji i agjencisë

Ndërmjetësuesi-----

Organizatori-----

10. Forma e investimit në pronësinë e biznesit tuaj?

- a) Biznes i themeluar nga fillimi,
- b) Përmes privatizimit,
- c) Blerjes nga investitorë të mëhershëm

11. Forma e pronësisë?

- a) Individuale,
 - b) Ortakëri.
- 12. Sa është kapaciteti juaj i akomodimit (numri i dhomave) sa e shfrytëzoni kapacitetin tuaj të akomodimit?**
- a) 5 dhoma
 - b) 10 dhoma
 - c) Më shumë se 10 dhoma
 - d) Të tjera
- 13. A keni arritur të rritni shitjen në tregun turistik lokal në vitin e fundit?**
- a) Po
 - b) Jo
- 14. A keni bashkëpunim me tour - operatorët turistikë?**
- a) Vendorë
 - b) Ndërkombëtarë
- 15. A keni e keni përshtatur zhvillimin e biznesit tuaj me ambientin rrethues?**
- a) Po
 - b) Jo
- 16. Ku e bazoni strategjinë e zhvillimit tuaj turistik?**
- a) Investime të vazhdueshme në mirëmbajtje dhe zgjerim të kapaciteteve,
 - b) Investime në ofrim të produkteve të reja,
 - c) Investime në burime njerëzore,
 - d) Promovim, Marketing
- 17. A merrni pjesë në ngjarje turistike (panaire turistike) vendore e ndërkombëtare?**
- a) Po, në ato vendore,
 - b) Po, në ato ndërkombëtare,
 - c) Po, në ato vendore e ndërkombëtare,
 - d) Jo, nuk marrim pjesë.
- 18. A përdorni sistemin online të rezervimeve?**
- a) Po.

b) Jo

19. Cilin nga faktorët e mëposhtëm e vlerësoni për zhvillimi të biznesit tuaj?

- a) Shërbim të mirë,
- b) Lokacion të mirë,
- c) Çmimi më i ulët se konkurrentët,
- d) Përfitim ekonomik i qëndrueshëm

20. A mbani evidencë mbi përshtypjet e mysafirëve për?

- a) Shërbim të mirë,
- b) Lokacion të mirë,
- c) Çmim më të ulët se konkurrentët,
- d) Të gjitha më lart.

19. Cilin nga faktorët e mëposhtëm e vlerësoni për zhvillimi të biznesit tuaj?

- a) Shërbim të mirë,
- b) Lokacion të mirë,
- c) Çmimi më i ulët se konkurrentët,
- d) Përfitim ekonomik i qëndrueshëm

20. A mbani evidencë mbi përshtypjet e mysafirëve për?

- a) Shërbim të mirë,
- b) Lokacion të mirë,
- c) Çmim më të ulët se konkurrentët,
- d) Të gjitha më lart.

III. Sektori publik - komunat

Komuna _____

21. A keni strukturë të organizuar institucionale për sektorin e turizmit (sektor, divizion të turizmit)?

- a) Në nivel sektori,

b) Në nivel drejtorie.

22. Cilën strategji zhvillimore keni hartuar/zbatuar?

- a) Zhvillimin ekonomik,
- b) Zhvillimin e turizmit.

23. A ka plane rregulluese për zonat e caktuara?

- a) Turistike,
- b) Të mbrojtura,
- c) Hapësira në parqet nacionale.

24. A keni monument të trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të UNESCO?

- a) Po.
- b) Jo.

25. A keni buxhet financiar të ndarë për turizëm?

- a) Po.
- b) Jo.

26. A është përfshirë komuniteti lokal në vendimmarrje për zhvillim të turizmit?

- a) Po
- b) Jo

27. Cila është strategjia e marketingut për zhvillimin e turizmit?

- a) Organizimi i ngjarjeve,
- b) Promovimi i potencialeve turistike,
- c) Krijimi i lehtësirave fiskale ose të tjera.

28. A keni projekte për zhvillimin e turizmit ndërkufitar?

- a) Po.
- b) Jo.

29. Nga cilat institucione, nga niveli qendror, keni mbështetje institucionale për zhvillimin e turizmit?

- a) MTI
- b) MMPH
- c) MKRS
- d) MBPZHR
- e) MMPH
- f) MIRR
- g) MIE
- h) MF

30. Mbështetja nga niveli qendror ofrohet?

- a) Mbështetje financiare,
- b) Harmonizim të planeve të përbashkëta.

31. A ekziston bashkëpunimi në mes komunave të Kosovës?

- a) Po.
- b) Varet nga investimi në projektet e partneritetit publiko-privat?

IV. Turistët

32. Si keni arritur në Kosovë?

- a) Me makinë/me autobus,
- b) Me linjë ajrore,
- c) Udhëtim i organizuar grupor.

33. Si jeni njoftuar për këtë destinacion turistik?

- a) Kam vizituar edhe më parë këtë destinacion,
- b) Interneti / mediet,
- c) Miqtë dhe të afërmit,
- d) Nga turistët që kanë vizituar më herët këtë destinacion turistik,
- e) Oferta turistike nga agjencia turistike,
- f) Panairret/ekspozitat.

34. Sa net keni qëndruar /keni planifikuar të qëndroni në këtë destinacion turistik?

- a) Së paku 1 natë,
- b) Më shumë se 2 ditë,
- c) Më shumë se një javë.

35. Cilat janë arsyet kryesore që ju kanë joshur të vizitoni këtë destinacion turistik?

- a) Pushimi dhe rekreacioni,
- b) Rehabilitimi,
- c) Kam vizituar të afërmit dhe miqtë,
- d) Marrë pjesë në ngjarje të ndryshme,
- e) Kulturore,
- f) Hulumtime shkencore,
- g) Për biznes.

36. Në çfarë niveli janë plotësuar pritjet tuaja?

- a) Mirë,
- b) Shumë mirë,
- c) Plotësisht,
- d) Ka tejkaluar pritjet e mia.

37. A keni pasur ndonjë arsye që të ankoheni/ të lavdëroni destinacionin?

- a) Po, kemi paraqitur ankesë,
- b) Po, kemi shprehur komplimentet tuaja,
- c) Jo.

38. Kush ju shoqëron në vizitën tuaj të tanishme në këtë destinacion turistik?

- a) Jam vetëm në këtë udhëtim,
- b) Partneri/ja,
- c) Familja,
- d) Miqtë.

39. Kur vendosët të qëndroni në këtë destinacion turistik?

- a) Më pak se një muaj më parë,

- b) 1 deri 3 muaj më parë,
- c) Më shumë se 3 muaj më parë.

40. Sa shkoni shpesh në pushime të cilat zgjasin të paktën 5 ditë?

- a) Një herë në vit,
- b) Disa here (2-4 herë) në vit,
- c) Më shumë se 4 herë në vit.

41. Sa keni shpenzuar, përafërsisht, gjatë vizitës tuaj në këtë destinacion turistik?

- a) Më Shumë se 100 €,
- b) Mbi 500 €,
- c) Mbi 1000 €